



**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**

— FERIZAJ —

**RREGULLORE E SIGURIMIT TË CILËSISË**



**UNIVERSITETI**  
I SHKENCAVE TË APLIKUARA  
— FERIZAJ —

Rektori  
Prof. Dr. Agron Bajraktari

Nr. Prot.: 520/20; Datë:18.02.2020

Në bazë të nenit 49 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF-it në mbledhjen e mbajtur me datën 18.02.2020, merr

**V E N D I M**

I.

Miratohet Rregullorja e sigurimit të cilësisë.

II.

Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

**A r s y e t i m**

Senati i UShAF-it për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore dhe rregullimit të procedurës për sigurim të cilësisë në UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Senatit të UShAF-it;
2. Njësive akademike të UShAF-it;
3. Arkivit të UShAF-it.

Rektori  
Prof. Dr. Agron BAJRAKTARI




Në bazë të nenit 15 paragrafit 1 të Ligjit për Arsimin e Lartë, nr. 04/L-037 dhe në mbështetje të nenit 49 dhe nenit 168, 169 dhe 170 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Senati i UShAF në mbledhjen e mbajtur më datën 18.02.2020 miraton këtë:

## **RREGULLORE E SIGURIMIT TË CILËSISË**

### **I.Dispozitat e përgjithshme**

#### **Neni 1 Qëllimi**

1. Me dispozitat e kësaj Rregullore përcaktohen standardet, procedurat dhe metodat e sigurimit të cilësisë dhe të vlerësimit të cilësisë të punës në Universitetin e Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejme Universiteti).
2. Kjo rregullore definon rolin dhe përgjegjësinë e njësive organizative në Universitet për realizimin e aktiviteteve të sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit.
3. Kjo rregullore definon mekanizmat dhe proceset që për afrojnë Universitetin - in me standardet e ENQA-s për sigurimin e cilësisë dhe vlerësimit.

#### **Neni 2**

**Me këtë Rregullore përcaktohet sigurimi dhe vlerësimi në këto fusha:**

- Strategjia për sigurimin e cilësisë;
- Strukturat organizative për sigurimin e cilësisë;
- Subjektet e sigurimit të cilësisë;
- Programet studimore;
- Procesi arsimor;
- Puna arsimore dhe shkencore - hulumtuese;
- Resurset njerëzore (stafi akademik dhe jo akademik);
- Studentët;
- Tekstet shkollore, literatura, biblioteka dhe kabinetet e informatikës;
- Menaxhimi në Universitet;
- Ambienti (hapësirat arsimore) dhe pajisjet;
- Përfshirja e studentëve në procesin e sigurimit dhe përparimit të cilësisë të punës;
- Alumni (të diplomuarit);

1

- Punëdhënësit.

## II. Qëllimet e vlerësimit

### Neni 3

**Vetëvlerësimi, si hap i parë në procesin e vlerësimit të cilësisë, ka disa qëllime kryesore:**

- Të paraqes një pasqyrë të shkurtër dhe përmbajtësore të procesit mësimor – arsimor të Universitetit dhe të programeve studimore;
- Të analizojë ndërlidhjen e procesit mësimor – arsimor dhe veprimtarisë shkencore hulumtuese dhe aplikative të institucionit;
- Të analizojë strukturën, cilësisë dhe përparimin e kuadrit akademik;
- Ti analizojë anët e forta dhe të dobëta të institucionit të arsimit të lartë, i cili kryen veprimtari të arsimit të lartë, me zbatimin e SWOT Analizës;
- Të sigurojë bazë e cila do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit që e realizon Institucioni;
- Të sigurojë bazën e cila do të shërbejë për kryerjen e vlerësimit të jashtëm;

### Neni 4

Universiteti e realizon vetëvlerësimin e programeve studimore në nivelin Bachelor dhe Master. Me vetëvlerësim të programeve studimore bëhet vlerësimi i cilësisë të veprimtarisë së arsimit të lartë dhe atij shkencor, përmes procedurave eksplicite për vlerësimin e cilësisë dhe kuadrit akademik.

Me vlerësimin e programit studimor duhet të përcaktohet se a i përgjigjet ai standardeve të pranura të Asociacionit Evropian për Sigurimin e Cilësisë (ENQA) dhe a korrespondon me praktikën internacionale. Duhet të vlerësohet se a mundëson struktura e programit studimor integrim të studentëve dhe profesionistëve të diplomuar në sistemet arsimore të vendeve të tjera të Hapsirës Evropiane të Arsimit të Lartë.

### Neni 5

**Përcaktimi për sigurimin dhe përparim të cilësisë së mësimdhënies në Universitetet realizohet nëpërmes elementeve vijuese:**

- Miratimin e strategjisë për sigurimin e cilësisë të mësimdhënies, si pjesë e strategjisë së përgjithshme të institucionit, nga ana e Senatit e cila është publike dhe subjekt i hulumtimit periodik;
- Ndërtimin e sistemit për sigurimin e cilësisë, duke përfshirë në mes të tjerave edhe krijimin e organeve përgjegjëse, standardeve dhe parimeve për sigurimin e cilësisë, si dhe definimin e qartë të roleve të të gjitha subjekteve në këtë proces.
- Planifikimin e aktiviteteve në fushat dhe aspektet me rëndësi të madhe për sigurimin e cilësisë të mësimdhënies, e veçanërisht lidhur me procesin mësimor, punën shkencore – hulumtuese, punën praktike, studimet më efikase dhe resurseve financiare;



- Përcjelljen e vazhdueshme dhe grumbullimin sistematik të të dhënave për sigurimin e cilësisë, nëpërmes organizimit dhe krahasimit të hulumtimeve periodike në të gjitha fushat e punës dhe krahasimi i rezultateve të fituara me planifikimin e bërë;
- Organizimin dhe krahasimin e hulumtimeve periodike të vet standardeve dhe procedurave për sigurimin e cilësisë, me qëllim të përparimit dhe përmirësimit të gjendjes ekzistuese.

### III. Misioni i vlerësimit

#### Neni 6

Misioni i vetëvlerësimit është zhvillimi dhe përmisimi i vazhdueshëm i cilësisë në funksion të përgatitjes së të diplomuarve për tregun e punës në vend dhe jashtë, si dhe përcaktimi i drejtimeve të veprimtarisë profesionale e shkencore.

### IV. Subjektet e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit

#### Neni 7

Subjektet për sigurim të cilësisë dhe të vlerësimit në Universitet janë: stafi akademik, stafi profesional dhe administrativ, punëtorët shkencor dhe hulumtues, bashkëpunëtorët, këshilli drejtues, senati, këshilli mësimor shkencor, komisionet universitare, bordi industrial si dhe studentët.

Me këtë Rregullore përcaktohen funksionet themelore dhe marrëdhëniet reciproke të të gjithë subjekteve në procesin e sigurimit të cilësisë, me qëllim të sigurimit konsistent, efikas dhe efektiv të sistemit për sigurimin e cilësisë të punës në Universitet.

### V. Komisioni për sigurimin e cilësisë

#### Neni 8

1. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë është organ kompetent për përcjelljen e vazhdueshme dhe sistematike si dhe grumbullimin e të dhënave rreth cilësisë, nëpërmes organizimit të hulumtimit periodik në të gjitha fushat e sigurimit të cilësisë, me qëllim të sigurimit dhe vetëvlerësimit të cilësisë së punës në Universitet.
2. Anëtarët e Komisionit për Sigurim të Cilësisë propozohen nga Rektori dhe zgjedhën nga Senati i Universiteti për periudhë katërvjeçare. Kryetar i Komisionit për Sigurim të Cilësisë është Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë (ex-officio).
3. Komisioni për Sigurimin e Cilësisë është komision këshillëdhënës i Senatit dhe përbëhet nga:

- Prorektori për Bashkëpunim Ndërkombëtar dhe Sigurim të Cilësisë (ex-officio);
  - Koordinatori për ECTS;
  - Zyrtari për çështje akademike;
  - Nga një përfaqësues nga çdo njësi akademike;
  - Një përfaqësues i deleguar prej Parlamentit studentor me notë mbi 8 dhe njohuri të mira të gjuhës angleze.
4. Së paku një e treta e anëtarëve të Komisionit Qendror për Sigurim të Cilësisë duhet të vazhdojnë në përbërjen e Komisionit pas mandatit 4 vjeçar për të siguruar vazhdimësinë e punës.

**Struktura e anëtarëve të Komisionit duhet ti shpreh këto karakteristika:**

- Të prezantohet secila strukturë e Universitetit (stafi akademik, studentët dhe administrata) që të sigurohet pjesëmarrje maksimale në vetëvlerësim të të gjithë subjekteve të interesuara;
- T'i përfaqësoj pikëpamjet e gjëra të Universitetit, dhe
- Anëtarët e Komisionit për vlerësim të jenë në gjendje t'i vlerësojnë anët e dobëta dhe të mira të Universitetit.

**Neni 9**

Detyrat e Komisionit për sigurim të cilësisë janë

- përcakton përmbajtjen e pyetësorëve të anketave;
- përcakton mënyrën e përpunimit të të dhënave si dhe listën e indikatorëve sipas të cilit vlerësohet kualiteti i realizimit të mësimit dhe programeve mësimore;
- përcakton formën e raporteve e cila i ofrohet Dekanit të njësisë përkatëse;
- përcakton formën e raportit që Komisioni për sigurim të cilësisë i dërgon Rektorit dhe Senatit lidhur me vlerësimin e punës me propozime për ndërmarrjen e masave të reja.
- Monitoron procesin e vlerësimit
- Miraton udhëzuesin dhe kalendarin akademik për sigurimin e cilësisë.
- I ruan të dhënat informative të evaluimit të cilësisë së Universitetit, mbledh të dhënat nëpërmjet modulit të SMU-së gjatë vitit aktual akademik dhe vitit vijues akademik, të cilat u'a ofron Fakulteteve.

**Neni 10**

Me procesin për sigurimin dhe vlerësimin e cilësisë nënkuptojmë aplikimin e vlerësimit të rregullt dhe të veçantë. Komisioni për sigurimin e cilësisë përgatit planet për implementimin e të gjitha aspekteve të vlerësimit, duke përfshirë lëminë e hulumtimit, angazhimin e subjekteve dhe planin e punës si dhe i raporton Senatit për rezultatet e treguara të vlerësimit, me propozime konkrete për ndërmarrjen e masave parandaluese, nëse kjo është e domosdoshme. Procesi i vlerësimit krijohet në bazë të analizave të dokumenteve dhe informatave të rëndësishme, krahasimit të planit të veprimit si dhe në grumbullimin e qëndrimeve dhe të dhënave të subjekteve në sistemin e sigurimit të cilësisë dhe të cilësisë nëpërmes të anketimit.



Komisioni për sigurimin e cilësisë përgatit raportin me rezultatet e vlerësimit dhe i'a dërgon Rektorit dhe Senatit, i cili e vlerëson cilësinë e punës në sektor të caktuar të Universitetit me propozime e masa për heqjen e pengesave në përparimin e cilësisë të punës.

#### **Neni 11**

##### **Vlerësimi i rregullt i cilësisë përfshinë fushat vijuese:**

- Programet studimore
- Procesi arsimor
- Stafi akademik dhe jo akademik
- Studentët;
- Infrastrukturën (Librat shkollor, literatura, biblioteka dhe kabineti i informatikës)
- Organizimi dhe funksionimi i sistemit për sigurimin e cilësisë
- Punësueshmërinë e studentëve.

Komisioni për vlerësimin e cilësisë, mund të organizojë vlerësimin e veçantë, me propozim të Rektorit dhe Senatit, me qëllim të vlerësimit të cilësisë në fushat e caktuara të sigurimit të cilësisë, për të cilat vlerësohet se janë të një rëndësie të veçantë për sigurimin e cilësisë të punës në tërësi.

#### **Neni 12**

##### **Procesi i vlerësimit sipas fushave bëhet si në vijim:**

- Vlerësimi i programeve bëhet nga studentët dhe akterët e jashtëm si bizneset, dhe alumni;
- Vlerësimi i procesit arsimor bëhet nga student çdo semester;
- Vlerësimi i stafit Akademik bëhet nga studente, vlerësimi kolegial, vlerësimi i menaxhmentit, dhe vetëvlerësimi;
- Vlerësimi i stafit jo-akademik (administrata) bëhet nga studentët dhe nga Sekretari i Pëgjithshëm i Universitetit një herë në vit.

#### **Neni 13**

##### **Koha e vlerësimeve**

- Vlerësimi i stafit akademik nga studentet bëhet një herë në semester;
- Vlerësimi i stafit akademik dhe administrativ për Universitetin një herë në vit;
- Vlerësimi i programit nga studentët një herë në vit;
- Vlerësimi kolegial një herë në vit;
- Vlerësimi nga menaxhmenti një herë në vit;
- Vetëvlerësimi i stafit akademik një herë në vit;
- Vlerësimi i programit nga akterët e jashtëm një herë në tri vite.



## **VI. Të drejtat dhe obligimet e Kryetarit dhe të anëtarëve të Komisionit për vlerësim**

### **Neni 14**

#### **Kryetari i Komisionit për Sigurim të Cilësisë;**

- Planifikon, organizon dhe koordinon punën e Komisionit;
- Përkujdeset që të mundësojë diskutim të gjerë për vlerësimin, me qëllim krijimin e një raporti të pranueshëm tërësisht për vlerësim;
- Realizon komunikim zyrtar me organet e Universitetit si dhe me Agjencinë e Kosovës për Akreditim (AKA), dhe;
- Kryen punë të tjera në lidhje me realizimin e vlerësimit.

### **Neni 15**

Anëtarët e komisionit për vlerësim kanë të drejtë dhe obligim që aktivisht të marrin pjesë në punën e komisionit, sa më gjerësisht që është e mundur të realizojnë kontakte dhe të prezantojnë mendimet e anëtarëve të Universitetit, si dhe të jenë në gjendje të vlerësojnë anët e dobëta dhe të forta të funksionimit të Universitetit.

### **Neni 16**

Komisioni për vlerësimin e cilësisë në Universitet, mund të formojë grupet e veta punuese me përfaqësues të studentëve të cilëve mund të i'u besohen punë dhe çështje të caktuara specifike, siç janë: vlerësimi i programeve të caktuara studimore, matjen të ngarkesës së studentit për lëndë, trajnimi i kuadrit akademik, dhe zhvillimi i tyre, shërbimet e studentëve dhe bashkëpunimi i jashtëm, aktiviteti ndërkombëtar e të ngjashme.

Komisioni për vlerësim ka obligim të marrë pjesë në trajnim të organizuar nga komisioni për vlerësim të universitetit, si dhe të organizojë trajnim për vetëvlerësim për pjesëmarrësit e tjerë në procesin e vetëvlerësimit.


## **VII. Planifikimi**

### **Neni 17**

Me qëllim të realizimit të misionit, Universiteti për çdo vit akademik, planifikon të gjitha aktivitetet me rëndësi për sigurimin e cilësisë. Propozim Planin e Punës për vitin akademik e përgatit Rektori i Universitetit, para fillimit të vitit të ri akademik dhe i'a dërgon Senatit për miratim.

#### **Plani i punës për vitin akademik përmban fushat vijuese:**

- Procesi arsimor: numri i nevojshëm i profesorëve dhe bashkëpunëtorëve, planet e punës dhe planet operative për çdo lëndë;
- Studentët: numri i studentëve sipas viteve, indikacionet për studime të suksesshme:



- Puna shkencore – hulumtuese dhe arsimore si dhe veprimtaria botuese, planifikimi i projekteve dhe publikimeve;
- Biblioteka: sigurimin e botimeve të reja.
- Hapësira dhe pajisje të nevojshme themelore për punë;
- Vlerësimi i cilësisë (ashtu siç është përcaktuar me këtë Rregullore)

## VIII. Cilësia e Programeve Studimore

### Neni 18

**Cilësia e programeve studimore sigurohet nëpërmes krijimit dhe përgatitjes së standardeve të posaçme dhe mekanizmave të përshtatshëm, me qëllim të:**

- Realizimit të misionit dhe vizionit në Universitetit;
- Realizimi i qëllimeve të programeve studimore;
- Parimit dhe efikasitetit të studimeve;
- Modernizimin e përmbajtjes së programeve studimore;
- Grumbullimin e vazhdueshëm të informatave lidhur me vlerësimin e cilësisë të programeve studimore nga akterët e ndryshëm sikurse: studentët, stafi, alumni, bizneset, etj.

Komision për sigurimin e cilësisë gjithashtu është i obliguar të bëjë vlerësimin e ngarkesës së studentit për lëndë para çdo procesit të vetëvlerësimit të programeve.

### Neni 19

**Hartimi i programit e studimit duhet të kalojë këto procese:**

- Iniciativa për një program të mund të rrjedh nga: Stafi akademik, bizneset, alumni, ekspertët e akreditimit;
- Iniciativa për program të ri shqyrtohet nga Komiteti i Programit dhe Senati krijohet ekipën punuese;
- Ekipa punuese në konsultim me: Stafin akademik, bizneset dhe alumni harton programin e ri;
- Hartimi i programit të ri duhet të verifikohet nga Komisioni për Cilësi së lidhur me përmbushjen e standardeve të Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA)
- Aprovimi i programit të ri duhet të bëhet nga Këshilli Mësimor - Shkencor dhe i dërgohet si propozim Senatit të Universitetit për miratim.

### Neni 20

Komisioni për sigurimin e cilësisë e përcjell efikasitetin e studimeve sipas programeve ekzistuese të studimeve, në bazë të dhënave nga zyra e shërbimit të studentëve dhe zyra për sigurim të cilësisë. Efikasiteti i studimeve matet sipas të dhënave vijuese:

- Përqindja e kalueshmërisë së studenteve nga një vit në tjetrin;
- Mesatarja e notave sipas viteve të studimit;

- Numri i studentëve të diplomuar;
- Mesatarja e notave të studentëve të diplomuar në të gjitha nivelet e studimeve;
- Përqindja e studentëve të diplomuar në krahasim me numrin e studentëve të regjistruar në çdo program studimor;
- Mesatarja e kohës së studimeve për çdo program studimor.

## IX. Cilësia e Procesit Mësimor

### Cilësia e procesit mësimor sigurohet nëpërmes:

1. Organizimit, përgatitjes dhe ndarjes së procesit mësimor në atë mënyrë që studentit të:
  - zhvillon aftësitë komunikative dhe interaktive në aplikimin e koncepteve teorike themelore;
  - zhvillon aftësitë të cilat do ti mundësojnë studentit që pavarësisht të punojë dhe të arrijë njohuri të reja;
  - të jetë anëtarë përgjegjës në punë grupore;
  - përparoj aftësitë e mendimit dhe zgjidhjes së problemeve;
  - zhvillon aftësitë e integritit të njohurive, dhe shkathtësi dhe aftësi tjera të përcaktuara me program të studimit.
2. Sigurimin e cilësisë së stafit akademik dhe joakademik, nëpërmjet sigurimit të raporteve profesionale në punë me studentë, sigurimit të kushteve të përshtatshme për punën kërkimore dhe hulumtuese në përsosshmërinë arsimore;
3. Sigurimin e numrit të nevojshëm të mësimeve dhe bashkëpunëtorëve, veçanërisht në krijimin e kushteve për zhvillimin e efikas të ligjëratave;
4. Sigurimin e fondit të librave në bibliotekë si dhe gjithë hapësirës së mjaftueshme në të;
5. Realizimi i vazhdueshëm të vlerësimit të cilësisë në këtë fushë, ashtu siç është përcaktuar në nenin 12 të kësaj rregulloreje.

### Neni 21

Me qëllim të sigurimit të cilësisë, teknikat e organizimit dhe përgatitjes së procesit mësimor përfshijnë definimin e planit mësimor, përditësimin e syllabuseve, dhe materialeve të tjera si: ligjëratat, ushtrimet, punën praktike dhe laboratorike, planet për organizimin e provimeve para fillimit të semestrit etj. Planet e tilla duhet të jenë të çashtme nga studentët më së largu ditën e parë të fillimit të semestrit.

### Neni 22

Planin për zhvillimin e procesit mësimor e përgatisin Dekanët e njësive akademike, nën mbikëqyrjen e Prorektorit për Mësim, Shkencë dhe Çështje Studentore, dhe i aprovon Rektori i Universitetit, duke marr parasysh Rregullorën e Ardhurave

Personale të Universitet për madhësinë e grupeve të mësim, mundësitë dhe kërkesat e studenteve, ngarkesën sipas lëndëve, shfrytëzimin efikas të hapësirës së Institutit dhe faktorët e tjerë.

Gjithashtu Dekanët e njësive akademike përgadisnin planet e organizimit të provimeve dhe i publikojnë konform rregullores për studime bachelor dhe master.

Shërbimi i studentëve duhet të jetë i azhuruar në vendosjen e planit për zhvillimin e procesit mësimor dhe të orareve të ligjëratave e të provimeve në tabelat e shpalljeve si dhe në Ueb faqen elektronike të Universitetit.

#### **Neni 23**

Me qëllim të rritjes së cilësisë së procesit mësimor, secili program i akredituar i Universitetit ka të drejtë të rrisë numrin e lëndëve të reja zgjedhore pa pasur obligim të kalojë në procedurë të akreditimit. Inicimi, procesi dhe apovimi për futjen e lëndës zgjedhore në një program duhet të bëhet konform procedurave të përcaktuara me udhëzuesin për sigurimin e cilësisë.

#### **Neni 24**

Komisioni për sigurimin e cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, nëpërmes anketimit, grumbullon qëndrimet dhe të dhënat për mësimdhënësit, në aspektet vijuese të vlerësimit të procesit mësimor:

- sigurimi i informacioneve të rëndësishme për procesin mësimor,
- mbajtjen e ligjëratave, testeve dhe provimeve, në pajtim me planin e paraparë;
- mbajtjen e raporteve profesionale të mësimdhënësve dhe stafit joakademik në raport me studentet,
- Krijimin e mundësit të ngritjen e aftësive dhe njohurive të mjaftueshme gjatë procesit mësimor në lëndë e caktuara, në pajtim me planin.

Lidhur me këtë, Komisioni përgatit raport për anketimin e zhvilluar, të cilin i'a dorëzon Këshillit Mësimor Shkencor.

## **X. Cilësia e punës shkencore - hulumtuese dhe arsimore**

#### **Neni 25**

Me qëllim të sigurimit të cilësisë së punës shkencore - hulumtuese dhe arsimore, si dhe me qëllim të sigurimit unik të punës shkencore-hulumtuese dhe arsimore, organet kompetente të Universitetit, si edhe të gjithë mësimdhënësit, pandërprerë angazhohen në krijimin, përgatitjen dhe realizimin e programit arsimor, shkencor dhe projektet hulumtuese, në pajtim me:

- Strategjinë e sigurimit të cilësisë dhe Politikën e cilësisë së Universitetit;
- Nevojave dhe pritjeve të shoqërisë;
- Praktikën me të mirë të institucioneve të huaja arsimore, shkencore dhe hulumtuese;

- Nevojat për sigurimin e cilësisë në fushat e tjera të Universitetit;
- Disponimi me resurset e brendshme dhe të jashtme për realizimin e programeve dhe projekteve.

#### Neni 26

Veprimtaria shkencore hulumtuese dhe artistike vlerësohen sipas:

- Numrit të publikimeve në tri vitet e fundit;
- Numrit të citimeve nga autorët e huaj (të dhëna nga bazat e citimeve);
- Numrit të përgjithshëm të projekteve të paraqitura në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare);
- Numrit të përgjithshëm të projekteve të realizuara në tri vitet e fundit (kombëtare dhe ndërkombëtare)
- Pjesëmarrja në seminare, konferenca, tryeza shkencore etj (vendore dhe ndërkombëtare) në tri vitet e fundit;
- Numrit të përgjithshëm të takimeve/diskutimeve/tryezave shkencore të organizuara në tri vitet e fundit nga ana e Universitetit.

### XI. Cilësia e Mësimdhënësve

#### Neni 27

Sigurimi i cilësisë së mësimdhënësve realizohet nëpërmes aktiviteteve adekuate në procesin e udhëheqjes me resurset njerëzore, si në vijim:

- Planifikimit të vazhdueshëm dhe përcjelljes së nevojave për angazhimin e mësimdhënësve në fushat e ndryshme shkencore - hulumtuese dhe arsimore;
- Përzgjedhja e mësimdhënësve sipas Statutit dhe Rregullores së veçantë për zgjedhjen e stafit akademik të Universitetit, duke i përcaktuar kriteret dhe procedurat;
- Krijimin e kushteve për përsosshmërinë e vazhdueshme arsimore dhe shkencore të mësimdhënësve;
- Përcjelljen permanente dhe të rregullt të vlerësimit të cilësisë në këtë fushë, ashtu siç është e paraparë në këtë Rregullore.

#### Neni 28

Komisioni për sigurimin e cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, nëpërmes pyetësorëve, anketave, intervistave, monitorimit, vlerësimit të performancës nga dekani, vlerësimit kolegial dhe vetëvlerësimit mbledh qëndrimet dhe të dhënat e studentëve për cilësinë dhe cilësinë e mësimdhënësve në procesin mësimor, në fushat vijuese:

- mbajtjen e mësimit në pajtim me planin e punës për lëndë;
- përcjelljen e njohurive dhe ligjëratave interaktive;
- zhvillon aftësitë e tij përmes synimeve plotësuese në lëndë dhe në programet studimore;
- përdorimin e teknologjisë së re informative gjatë ligjëratave;
- motivimin e studentëve për të marr pjesë në ligjëratat, punët hulumtuese

- grupore apo të vetme;
- kriteret e notimit, nga aspekti i transparencës dhe drejtësisë

## **XII. Kriteret për zgjedhjen dhe vlerësimin e cilësisë së kuadrit akademik**

### **Neni 29**

Zgjedhja e kuadrit akademik bëhet në pajtim me kriteret dhe procedurat për zgjedhje në tituj akademik të përcaktuara me Statutin e Universitetit, respektivisht me Rregulloren për zgjedhjen, emërimin, riemërimin dhe avancimin e stafit akademik të Universitetit.

Vlerësimi periodik i cilësisë së kuadrit akademik i Universitetit, bëhet nga ana e organeve të Universitetit.

Vlerësimi i cilësisë së kuadrit akademik bëhet sipas:

- Kualifikimit të kuadrit akademik, në pajtim me aktet e përgjithshme të Universitetit;
- Zbatimin në praktikë të kriterëve për përzgjedhjen në nivel të Universitetit;
- Mbulimi i të gjitha fushave shkencore me kuadër akademik;
- Realizimi i anketave të rregullta me studentët për cilësinë e kuadrit akademik dhe përfshirja e mendimit të studentëve në portofolin e stafit akademik ;
- Organizimin e kurseve të obligueshme për trajnim dhe zhvillim të kuadrit akademik.

## **XIII. Masat për përmirësimin e cilësisë**

### **Neni 30**

Këshilli Mësimor/Shkencor i Universitetit, i cili kryen veprimtari të arsimit të lartë, në bazë të Raportit të vlerësimit nga komisioni i sigurimit të cilësisë për kuadrin akademik, propozon dhe ndërmerr masa për përmirësimin e tyre.

## **XIV. Cilësia e studentëve**

### **Neni 31**

Sigurimin e cilësisë së studentëve, Universiteti e realizon përmes aktiviteteve dhe standardeve në fushat vijuese:

- selektimin e studentëve me rastin e regjistrimit të tyre;
- procesit arsimor;
- organizimit të studentëve në mësimore;
- përcjelljen e vazhdueshme dhe vlerësimin e rregullt të cilësisë në këtë fushë në pajtim me këtë Rregullore

### Neni 32

Universiteti garanton barazinë e të gjithë studentëve, pa marr parasysh racën, ngjyrën, gjininë, nacionalitetin, gjuhën, fenë, mendimin politik etj. Universiteti i'u mundëson studentëve organizimin dhe veprimtarinë e tyre nëpërmes të organizatave së tyre studentore, konform Statutit dhe akteve të tjera normative.

### Neni 33

Me qëllim të sigurimit të cilësisë në këtë aspekt, me rastin e regjistrimit të studentëve, aplikohet Rregullorja për Përcaktimin e Procedurave për Regjistrimin e Studentëve në Universitet.

## **XV. Cilësia e teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabineteve informatike**

### Neni 34


Sigurimi i cilësisë së teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabineteve të informatikës, është i domosdoshëm në zhvillimin e suksesshëm të procesit arsimor dhe realizohet përmes:

- sigurimit të teksteve shkollore të cilat mundësojnë realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas programit studimor dhe lëndëve;
- sigurimin e fondit të mjaftueshëm të literaturës, fond i cili mundëson realizimin e qëllimeve të përcaktuara sipas planprogrameve studimore dhe lëndëve;
- sigurimin e pajisjeve moderne në kabinetin e informatikës për zhvillimin e procesit mësimor dhe për nevojat e studentëve;
- sigurimin e hapësirës së mjaftueshme për shfrytëzimin efikas të bibliotekës dhe kabinetit të informatikës nga ana e studentëve, mësimdhënësve të Universitetit.

### Neni 35

Komisioni për sigurimin e cilësisë, në procesin e vlerësimit të rregullt, përmes anketimit grumbullon të dhënat dhe qëndrimet e studentëve, mësimdhënësve, në aspektet vijuese të cilësisë të teksteve shkollore, literaturës, bibliotekës dhe kabinetit të informatikës:

- pajisja e mjaftueshme me tekste shkollore sipas standardeve akademike dhe vlerësimi sipas ECTS kredive;



- përmbajtja e teksteve shkollore me të dhëna të mjaftueshme, sipas kërkesave të studentëve gjatë marrjes së diturive në lëndë të caktuara;
- pajisja e mjaftueshme e bibliotekës me literaturë dhe tekste shkollore dhe mundësia e çasjes së studentëve në bibliotekë;

## **XVI. Cilësia e udhëheqjes së Universitetit**

### **Neni 36**

Cilësia e udhëheqjes së Universitetit, realizohet nëpërmes aplikimit të plotë dhe të drejtë të Ligjit mbi Arsimin e Lartë, të Statutit të Universitetit dhe akteve të tjera të përgjithshme në lidhje me përgjegjësitë dhe autorizimet e të gjitha organeve të Universitetit, me qëllim:

- realizimit të misionit dhe vizionit të Universitetit
- sigurimin e cilësisë së punës së Universitetit.

## **XVII. Cilësia e hapësirës arsimore dhe pajisjeve**

### **Neni 37**

**Sigurimi i cilësisë së hapësirës arsimore dhe pajisjeve realizohet përmes;**

- sigurimit të hapësirës dhe pajisjeve të teknologjisë së re informative, për realizimin e qëllimeve të cilësisë të procesit arsimor, së paku në pajtim me standardet kombëtare;
- sigurimin e pandërprerë të lidhjes së internetit dhe lënien në dispozicion për mësimdhënësve dhe studentët;
- përcjelljen e vazhdueshme dhe vlerësimin e cilësisë të këtyre pajisjeve sipas numrit të studentëve si dhe sipas kërkesave për sigurimin e cilësisë së programeve studimore, procesit arsimor dhe procesit hulumtues - kërkimor dhe shkencor të Universitetit;
- udhëheq dhe bënë evidentimin e pajisjeve;
- aplikimin e masave të përshtatshme për siguri, mbrojtje të shëndetit të punësuarave, studentëve dhe të gjithë personave të tjerë që janë për rreth tyre, në përputhje me ligjin.

## **XVIII. Bashkëpunimi i jashtëm, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun**

### **Neni 38**

**1. Bashkëpunimi nacional vlerësohet sipas:**

- bashkëpunimit me ekonominë, institucionet qeveritare dhe me asociacionet tjera profesionale nacionale, në kontekst të misionit, qëllimeve dhe detyrave të institutit;

- numrit të përgjithshëm të projekteve në pesë vitet e fundit;
- kontakteve dhe bashkëpunimit me studentë të diplomuar dhe me asociacionet e tyre;
- kontakteve me punëdhënësit e të diplomuarve
- Alumni (të diplomuarit)

### 2. Bashkëpunimi ndërkombëtar vlerësohet sipas:

- pjesëmarrjes në programe arsimore evropiane (Erasmus+, Horizon 2020, e të tjera në tri vitet e fundit;
- dimensionit ndërkombëtar të programeve studimore;
- shkëmbimit të kuadrit akademik me qendrat e tjera akademike në vend dhe jashtë;
- shkëmbimi i studentëve me qendra tjera akademike në vend dhe jashtë mësimi në gjuhë të huaja;
- shfrytëzimi i literaturës së huaj.

### 3. Marrëdhëniet me publikun vlerësohen sipas:

- ditëve të hapura të Universitetit për njohjen e studentëve të ardhshëm me mundësitë për studim në Universitet;
- bashkëpunimit me mediumet e shkruara dhe elektronike;
- pjesëmarrja në panairë për arsimim.

## **XIX. Raporti i Vetëvlerësimit**

### **Neni 39**

Pas realizimit të vetëvlerësimit në Universitet, me propozim të Komisionit për Sigurim të Cilësisë, Senati formon komisionin për hartimin e Raportit të Vetëvlerësimit, dhe atë Institucional dhe të programeve.

Komisioni për hartimin e RVV-se përgatit raportin në mënyrë të hapur dhe publike konform standardeve nacionale dhe ndërkombëtare të sigurimit të cilësisë.

RVV hartohet sipas udhëzimeve të dhe manualit për hartimin e tyre të përcaktuar nga Agjencia Kosovare e Akreditimit dhe bëhet së paku një herë në tri vite.

RVV për programe hartohet një herë në tri vite.

## **XX. Qasja e Raportit të Vetëvlerësimit për pjesëmarrësit në vlerësim**

### **Neni 40**

Raporti për vetëvlerësim duhet të jenë në dispozicion të të gjithë anëtarëve në mbledhjet që do të mbahen gjatë kohës së vizitës së ekspertëve në Universitet, nga Agjencia e



Kosovës për Akreditim (AKA), komisioni për vlerësim i Universitetit apo ekipit të saj si dhe nga trup për vlerësim të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës apo ekipit të tij.

## **XXI.Hyrja në fuqi e Rregullores**

### **Neni 41**

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e miratimit nga Senati i Universitetit.

### **Neni 42**

Me hyrjen në fuqi të kësaj rregullore, shfuqizohet Rregullorja për procedurat e sigurimit të cilësisë dhe vlerësimit nr. 1013/19 e datës 04.04.2019.

**Rektori**  
**Prof. Dr.Agron Bajraktari**

